

Newsletter 4, Korrik 2016

Mirësevini në Newsletter-in e 4-të të MWL

Bën shumë vapë në Shqipëri dhe shkollat do të mbyllën së shpejti. Teksa moti ndryshon, kështu ndodh edhe me veprimtaritë e projekteve të MWL-së. Sezoni i verës në zonat turistike nënkupton hapjen e tregjeve për shitjen e produkteve të punuara me dorë nga grupi i grave të MWL. Të rinjtë e MWL vazhdojnë të përipiqen drejt qëllimit të tyre për të siguruar punësim, po planifikojnë edhe disa ditë së bashku gjatë verës.

Projekti Kombëtar i Arsimit i MWL po përgatit mjetet për Studimin Kombëtar mbi sistemin arsimor në Shqipëri, ndërsa studimi për projektin e MWL të Burrave ka përfunduar tashmë. Gradualisht, pjesë të analizës së të dhënave nga hulumtimi për projektin e MWL të Burrave po i prezantohen menaxherit të projektit, duke zbuluar ndërkaq disa surpriza rreth situatës dhe këndvështrimeve të burrave në Shqipëri. Ky projekt i kushtohet gjithashtu seancave të përjavshme në një prej burgjeve të burrave. Kjo nismë do të shtrihet së shpejti edhe në burgun e grave ku 7 trafikante femra janë dënuar së fundmi.

Qysh prej buletinit të fundit të publikuar në muajin Mars, situata e trafikimit dhe vulnerabiliteti i shumë personave në Shqipëri për shkak të varfërisë, korrupsionit dhe një humbje të konsiderueshme shprese, i kanë ngarkuar MWL-së detyrimin për të qenë sa më shpresëplotë. Nevojitet gjithashtu që të fuqizojmë përfituesit tanë në mënyrë që dhe ata të ndihen njësoj si ne.

Po bëhet gjithmonë e më e qartë që MWL duhet të trajtojë udhëheqësit midis grupeve të të rinjve, të ciët janë e ardhmja dhe shpresa e Shqipërisë. Kjo nismë e re do të fillojë në Tetor 2016. Është e rëndësishme që të mbetemi të hapur ndaj ndryshimit transformues dhe sfidave që ky paraqet për të gjithë ne.

Ndërkaq, së shpejti do të jetë koha për të marrë një pushim të shkurtër plotësisht të merituar. I urojmë të gjithë lexuesve tanë, përfituesve dhe partnerëve: Pushime të gëzuara dhe të sigurta.

Imelda Poole (President MWL)



Mary Ward Loreto

MWL për të Rijhtë, planifikimi i ngjarjeve të fundit: Vullnetarizmi për fushatën UN Gift box, trajnim për siper marrjen.

Mbrojtja e Viktimave të trafikimit përtej kufijëve.

Projekti i MWL për Grate përfundoi kërkimin mbi OJQ-të në Tiranë dhe është e gatshme për të hapur qëndren për këshillimin e Grave.

Zhvillimi i punës në burgje në Tiranë/Durrës, duke iu përgjigjur nevojave të tyre.

Projekti i MWL për burra ndihmohet nga punojës të rinj. Hulumtimi është përfunduar dhe rezultatet janë sfiduese për punën tonë të ardhshme.

Fuqizimi Përmes Drejtësisë Lirisë dhe Sinqeritetit

Miqtë e Mary Ward, Takime mujore. Takim ndërkombëtar në Mbretërinë e Bashkuar ne 2017.

Projekti i MWL për Grate: Hapja e tregjeve verore: Bashkëpunim me institucionet shtetërore.

Fushata UN Gift Box drejtuar nga URAT, një rrjet kundër trafikimit bazuar në Mary Ward Loreto

Projekti i MWL për Edukimin po zhvillon hulumtimin e sistemit kombëtar arsimor që çon në ndryshimin e tij.

Puna në Terren

Projekti Kombëtar i Arsimit i MWL

Gjatë kësaj periudhe, shumë punë është realizuar për të nisur projektin e MWL për Arsimin në Shqipëri. Ky projekt është përqendruar mbi një analizë të Etikës dhe Korrupsionit në Sistemin Arsimor në nivel kombëtar. Hulumtimi do të jetë cilësor dhe sasior në mënyrë që të sigurojë një kuptim sa më të plotë të realitetit në këto institucione dhe të bëjë një krahasim të rezultateve me praktikën më të mira ndërkombëtare. Një ekip i plotë është punësuar. Bordi i Arsimit i MWL ka qenë një organ kyç drejtues përgjatë fillimit të vënies në zbatim të projektit pilot, i cili nisi në muajin Mars 2016. Tashmë, një menaxhere projekti nga Universiteti i Tiranës është caktuar së fundmi. Një këshilltar dhe trajner nga Kompania Mirnes janë angazhuar për shërbimet e tyre profesionale. Një kompani hulumtuuese, ACER, është kontraktuar tashmë për të udhëhequr aspektet logjistike të hulumtimit nëpër të gjithë Shqipërinë, nga Kopështi deri në nivel Universiteti. Të gjitha raportet përfundimtare do të realizohen në bashkërendim me skuadrën e MWL për Arsimin, të udhëhequr nga Menaxheri i Projektit dhe Bordi i MWL për Arsimin. Ministri i Arsimit është në kontakt me menaxherin e projektit përgjatë këtij procesi.



Ky projekt konsiderohet një sipërmarrje shumë e madhe me ndikim për të ardhmen e Shqipërisë dhe nxitjen e ndryshimit sistemik. Projekti do të nxjerrë në pah nivelin e korrupsionit dhe mungesën e etikës në shumë institucione arsimore në Shqipëri. Konferenca e projektit, në të cilën do të prezantohen të gjitha gjetjet, do të mbahet gjatë javës së parë të prillit, duke përfunduar në Tiranë më 7 prill.

Fushata “UN Gift Box” në Shqipëri

vjen si një bashkëpunim midis disa OJF-ve të ndryshme dhe Kongregacionet fetare të cilat kanë të përbashkët luftën kundër trafikimit në Shqipëri. Mary Ward Loreto është e orientuar drejt ndërtimit të një ure bashkëpunimi dhe komunikimi mes organizatave kundër trafikimit, duke përfshirë viktimat dhe shërbimet e ofruara ndaj tyre, me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin rreth kësaj çështjeje.

Fushata “UN Gift Box” është një version Shqiptar, një nismë e "Stop the Traffik" dhe "Iniciativës së Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Trafikimin e Njerëzve”. Ky projekt rrit ndërgjegjësimin publik rreth problemit të trafikimit dhe pasojave të tij, përmes një objekti në formën e një kutie, i cili vendoset në rrugë dhe është i aksesueshëm nga të gjithë. Në pjesën e jashtme të "UN Gift Box" janë shkruar fraza të përdorura nga trafikantët për të bërë ofertat e tyre sa më tërheqëse, ndërsa pjesa e brendshme e kutisë tregon realitetin që shoqëron më pas këto premtime.

Që nga viti 2012, ky projekt është zbatuar me sukses në 6 shtete dhe ka afektuar një audiencë prej 55,000 njerëz. Për të maksimizuar ndikimin e projektit, "UN Gift box" me përmasa 225x225 cm do të lëvizë në katër qytete të Shqipërisë: Durrës, Sarandë, Shkodër dhe për të përfunduar më 18 tetor në Tiranë - në Ditën Evropiane kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Në këtë datë, fushata e UN Gift Box do të mbyllet në Tiranë ku dhe do të organizohet një Festival Filmi në një prej sallave të qytetit.

Do të bashkëpunojmë ngushtësisht me Ministrinë e Punëve të Brendshme, bashkitë e këtyre qyteteve si dhe organizata të ndryshme dhe vullnetarë. Znj. Elona Gjebrea, Zëvendës Ministre e Punëve të Brendshme do të jetë e pranishme në hapjen dhe mbylljen e fushatës në Durrës dhe në Tiranë.

Hajdeni dhe Bashkohuni në misionin tonë. Të gjithë së bashku jemi më të fortë teksa ngrejmë zërin për të parandaluar trafikimin e qënieve njerëzore.



I was promised

There are an estimated 21 million people enslaved today, 4.5 million (21%) of which are in the sex industry.
 Prof. A.G. Global estimate of forced labour, Geneva, 2012.

The illegal profits made from the use of forced labor amount to \$100 billion per year. 2/3 of this profits, \$66 billion per year, are generated by commercial sexual exploitation.
 Profits and poverty: The Economics of Forced Labor, ILO 2014.

Shekulli është i mbushur me njerëz të detyruar të punojnë në kushte të rrepta dhe të rrezikshme për shkak të detyrës së punës. Ata shpesh janë të varfër dhe të detyruar të punojnë në kushte të rrepta dhe të rrezikshme për shkak të detyrës së punës. Ata shpesh janë të varfër dhe të detyruar të punojnë në kushte të rrepta dhe të rrezikshme për shkak të detyrës së punës.

Shekulli është i mbushur me njerëz të detyruar të punojnë në kushte të rrepta dhe të rrezikshme për shkak të detyrës së punës. Ata shpesh janë të varfër dhe të detyruar të punojnë në kushte të rrepta dhe të rrezikshme për shkak të detyrës së punës. Ata shpesh janë të varfër dhe të detyruar të punojnë në kushte të rrepta dhe të rrezikshme për shkak të detyrës së punës.

- Më poshtë janë datat në të cilat do të zhvillohet fushata në secilin qytet:
- Nga 26 Korrik deri më 2 Gusht në Durrës;
 - Nga 3 deri 10 Shtator në Sarandë;
 - Nga 1 deri 8 Tetor në Shkodër;
 - Nga 15 deri 22 Tetor në Tiranë;

Prezantimi në Kombet e Bashkuara, Prill 2016

Shumë lexues do të kenë dëgjuar rreth informacionit të prezantuar nga Motër Imelda para Kombeve të Bashkuara rreth trafikimit të njerëzve si dhe rolit të RENATE për zvogëlimin e numrit të viktimave të trafikimit në Evropë. Nëse nuk e keni dëgjuar më parë dhe dëshironi ta dëgjoni atë, mund të vizitoni faqen tonë të internetit www.albaniahope.com dhe të klikoni mbi linkun në fund të kryefaqjes. Aty do të keni mundësi gjithashtu që të dëgjoni të gjitha fjalimet e mbajtura atë ditë. Kryepeshkv Auza, ambasadori i Selisë së Shenjtë në OKB shkroi pas eventit: "Pjesëmarrja e lartë në këtë event ishte një shenjë e nxitjes së paepur të shumë aktorëve në komunitetin e Kombeve të Bashkuara, si dhe atyre në frontin e parë në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore, punës së detyruar dhe gjitha formave të skllavërisë moderne për të punuar me vendosmëri dhe shpresë për arritjen e Synimeve 8.7, 5.2 and 1.6.2 të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe zhdukjen e këtij problemi madhor. Në vijim të këtij eventit, Misioni ynë do realizojnë një përmbledhje "Acta" me qëllim që ndërhyrjet dhe propozimet konkrete të bëra në këtë Konferencë të shtrihen mbi një audiencë sa më të gjerë të mundshme. Faleminderit që i keni dhënë tashmë një kopje të fjalimeve tuaja Fr Roger Landry në Selinë e Shenjtë, në mënyrë që ato të kenë mundësi të përfshihen aty" Ai përfundoi duke thënë: 'Faleminderit shumë!!' Kryepeshkv Auza ka qenë diplomat i Vatikanit në ambasadën në Shqipëri, menjëherë pas rënies së regjimit komunist.



Ending Human Trafficking by 2030: The Role of Global Partnerships in Eradicating Modern Slavery

Vizita në Norvegji dhe Danimarkë në emër të RENATE

Megjithëse RENATE është e përfaqësuar tashmë në 25 shtete Evropiane, nuk ka patur asnjë zë që të dëgjohej nga personat që punojnë në terren në Skandinavi, vende në të cilat trafikohen shumë shtetas të Evropës Lindore. Motër Adina Balan CJ dhe Motër Imelda Poole IBVM përfaqësuan RENATE në këtë drejtim. Më poshtë paraqitet një listë e organizatave të cilat vizituam gjatë udhëtimit tonë pesë ditor. Shumica e këtyre organizatave kanë faqet e tyre në internet.

- **Oslo:** Motrat Domenikane, Kirkens Bymisjon, Pro Sentret, Fondacioni Rosa, Caritas Norvegji, Tryeza e rrumbullakët e Organizatave Katolike në Oslo.
- **Kopenhagen:** Reten International, Motrat e Vogla të Jezusit, KIT: Kirkens Integrations Tjeneste.
- **Kisha Baptiste Suedeze:** Pastori Sven-Gunnar nga Suedia kishte ardhur në Kopenagen që të ekspozonte historinë e viktimave të trafikimit, duke filluar me realitetin e viktimave dhe ëndrrën e tyre, për të vijuar me prezantimin e shkatërrimit të kësaj ëndrre, torturën, shpëtimin dhe rehabilitimin e viktimave, si dhe dënimin përfundimtar të trafikantëve. Prezantimet u shfaqën në tre tenda, me një përdorim të shkëlqyer të dritës dhe ngjyrave të cilat e ekspozonin shikuesin ndaj ndjenjave të të trafikuarve.



Këto ditë në Skandinavi na dhanë shpresë për të ardhmen falë lidhjeve të realizuara dhe dialogut të vazhdueshëm me persona nga kjo pjesë e Evropës. Në të njëjtën kohë, kjo ishte një mundësi e mirë për ne që të kuptonim modelin Nordik – Ligji në Suedi dhe Norvegji kriminalizon përdoruesin në industrinë e seksit dhe jo punonjësin e seksit. Ishte shumë e dobishme për të kuptuar se ka një dallim midis ligjit në letër dhe zbatimit të tij në shtete të ndryshme. Është mjaft me interes për RENATE që të ketë anëtarë nga këto vende dhe sidomos, ata, vendet e të cilëve po marrin në konsideratë këtë model. Përfundimisht, kjo vizitë u dha anëtarëve të RENATE më shumë se sa mund të ishte shpresuar në këtë moment të historisë së Fondacionit.

Mary Ward Loreto viziton OSBE

Ana Stakaj, menaxherja e projektit të MWL për Gratë dhe Imelda Poole patën privilegjin që të vizitonin zëvendës drejtorin e OSBE dhe kolegët e tij të cilët punojnë në fushën kundër trafikimit dhe drejtorinë e Qeverisjes. OSBE luan një rol të rëndësishëm në Shqipëri. Ata shpallorin detyrat e tyre në faqen e internetit: "Siguria prek shumë aspekte të mënyrës se si jetojmë dhe qeverisemi. Këndvështrimi i gjerë i OSBE mbi sigurinë mbulon tre 'dimensione': politik-ushtarak; ekonomik dhe mjedisor; si dhe njerëzor. Veprimtaritë e OSBE mbulojnë që të tre këto fusha, nga çështjet e "forta" si parandalimi i konfliktit dhe nxitja e zhvillimit ekonomik, siguri i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe promovimi i respektit të plotë për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore."

Z. Wilton foli rreth vizitës së MWL si një moment me rëndësi për shtrimin e rrugës për bashkëpunim në të ardhmen. Ai tha se ishte i impresionuar nga larmishmëria e punës së MWL dhe foli për nevojën për të mbajtur kontakte të vazhdueshme, dhe kurdo që të ishte e mundur, të bashkërendojmë në plotësim të njëra-tjetrës. Të gjithë ramë dakord se do të ishte mjaft me përfitim nëse do të gjenim një mënyrë se si mund të punojmë së bashku në të ardhmen. Jemi të vetëdijshëm për nevojën e zhvillimit të këtij bashkëpunimi.

Tani OSBE-ja ka ftuar MWL për të marrë pjesë në një seminar në Mal të Zi në fund të Gushtit për Migracionin dhe trajtimin e çështjeve të trafikimit.

Zhvillimi i Faqes së Internetit dhe Marketingu

Në strategjinë e saj për zhvillimin e burimeve njerëzore, MWL zbaton një metodologji e cila synon ndërtimin e vlerave për fuqizim. Baza e kësaj metodologjie është karizma e Mary Ward: Liria, Drejtësia dhe e Vërteta. MWL po mundëson njerëzit që të arrijnë potencialin e tyre të plotë përmes trajnimit, këshillimit, mbikëqyrjes dhe kujdesit.

Në qershor, menaxherët e MWL u trajnuan në Marketing. Znj. Annie Bannister, një Konsulente Marketingu dhe Faqe Interneti nga Mbretëria e Bashkuar, udhëhoqi menaxherët përmes këtij trajnimi ku ata u sfiduan për të gjetur mënyra të reja për të promovuar punën e MWL dhe për të përfshirë më shumë njerëz në këtë mision.

Një plan i ri marketingu do të krijohet për vitin e ardhshëm. Annie Bannister trajnoi gjithashtu për dy ditë menaxheren tonë për zhvillimin e faqes së internetit. Trajnimi ishte përqendruar mbi përdorimin teknik të mediave sociale.



Migrimi i Sigurt

Më 13 Maj, ekipi i MWL në zyrën qendrore të Fondacionit u bë pjesë e një experience të veçantë. Nën drejtimin e Besfort Lamallari, ekipi u njoh me fenomenin e Migrimit dhe sfidat e tij të fundit. Besforti prezantoi shkallën e migrimit në Mesdhe dhe mënyrat se si duhet të përballemi me këto sfida. U njohëm gjithashtu me proceset e Migrimit të Sigurt. Në këtë trajnim, çështje si Konteksti i Migrimit, Llojet e Migrimit, faktorët Shtytës dhe Nxitës në vendet e origjinës dhe destinacionit, apo faktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë që karakterizojnë këtë fenomen u bënë pjesë e diskutimit, i cili trajtoi mjaft mirë këto çështje. Përmes 'brainstorming' dhe punës në grup, ekipi evidentoi një sërë rekomandimesh të cilat do të zënë vend shumë shpejt në veprimet e përditshme të anëtarëve të ekipit. Synimi i këtij trajnimi ishte të promovonte Migrimin e Sigurt, si dhe të ofronte objektiva për të punuar me mjetet e duhura për nxitjen e lëvizjes së sigurt.



Radikalizimi

Më 2 qershor, ekipi i MWL u bë pjesë e një eksperience totalisht të re. Ata u ftuan që të merrnin informacion rreth një çështjeje globale e cila përbën shqetësim për të gjithë profesionistët përqark botës. Besfort Lamallari, bashkë-autor i studimit 'Radikalizmi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri' udhëhoqi trajnimin dhe prezantoi gjerësisht sfondin e këtij problemi global dhe se si ky fenomen afekton shoqërinë Shqiptare. Ai lehtësoi punën e ekipit për zhvillimin e hapave konkrete të cilat mund të përkthehen në veprime të përditshme në punë. Besforti prezantoi koncepte të reja si Ekstremizmi i Dhunshëm, Luftëtarët e Huaj, faktorët bazë dhe nxitësit e Radikalizimit. Ai shpjegoi gjithashtu koncepte që shpesh keqpërdoren si Tekfirizmi, Xihadi, Martir (Shehid) dhe Mos-pjesëmarrja në votime. Ai shpjegoi më tej teknikat e Radikalizimit dhe ndikimin e tyre mbi grupin më vulnerabël: Të rinjtë. Besforti trajtoi gjithashtu lidhjen mes Radikalizmit, Politikës dhe Fesë, duke bërë të qartë kontekstin e proceseve të shfrytëzuara për qëllime manipulimi. Në përfundim të trajnimit, ekipi, i ndihmuar nga Besforti u bënë më të vetëdijshëm rreth punës së mrekullueshme që mund të bëhet në drejtim të parandalimit të Radikalizimit me qëllim për të ndihmuar çdokënd që të jetojë i lirë, me dinjitet dhe me respekt.

Trajnimi i Stafit të MWL - Programi i Kujdesit për Stafin, Prill 2016

Mary Ward Loreto ka një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fuqizimit të kapaciteteve të stafit të organizatës, duke përfshirë zhvillimin profesional. Është bërë tashmë traditë që çdo vit MWL cakton një javë të veçantë për kujdesin ndaj stafit. Këtë vit, kjo javë u mbajt nga data 25 deri më 29 Prill dhe ishte përqendruar mbi multimedian. I gjithë stafi pati një kohë të frytshme dhe të kënaqshme së bashku. Kjo veprimtari u zhvillua në Durrës dhe Berat, një qytet historik në jug të Shqipërisë. Një specialist i multimedias ishte ftuar që të shoqëronte stafin gjatë pesë ditëve të veprimtarive mbi temën e Medias dhe Multimedias, përdorimi i tyre dhe se si ato mund të përdoren nga persektiva e një Organizate Jo-Fitimprurëse.

Gjatë dy ditëve të trajnimit, stafi u njoh me konceptet themelore të medias dhe multimedias, siç janë filmi, dokumentari, reportazhi, lajmet, fotot dhe gazetaria. Trajnimi ishte shumë praktik dhe u përdorën teknika të grupit. Stafi u instruktua si të zhvillonin aftësi praktike dhe të mësonin përmes të vështruarit, të vepruarit dhe imagjinatës. Vizita në Berat ishte një ditë e mrekullueshme. Berati është një qytet i vjetër 2,400 vjeçar i pozicionuar mes qendrës dhe jugut të Shqipërisë. Njihet gjithashtu si “qyteti i njëmijë e një dritareve, apo dhe Qyteti Muze.” Është një prej qyteteve më të vjetër dhe të bukura të Shqipërisë, një vendbanim i cili ka ekzistuar që prej të paktën shekullin



e 6-të përpara Krishtit, kohë në të cilën ishte një vendbanim-kështjellë e fisit Ilir të Dasaretëve. Qyteti i vjetër u shtua në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në korrik 2008. Është një qytet i mrekullueshëm Otoman, i pasur me ndërtesa të bukura të cilat zgjojnë interesin më të lartë arkitekturor dhe historik. Përveç vizitimit dhe shijimit të qytetit të bukur të Beratit, stafi i MWL e ndërthuri këtë ditë me përdorimin e aparatit fotografik dhe të videos, duke regjistruar momentet më të bukura të ditës.

Trajnimi rreth multimedias përfshiu gjithashtu ndarjen në role, ku i gjithë stafi u ndanë në skuadra për të luajtur rolet e drejtorit ekzekutiv, kameramanit, montazhierit dhe rolin e producentit ekzekutiv. Stafi duhej të prodhonte katër materiale. Pas një pune të fortë dy ditore, stafi u nda në katër skuadra për realizimin e objektivave të tyre. Mbrëmjen e fundit të javës së kujdesit për stafin ishte organizuar me kujdes një event ku secila skuadër prezantoi temën që ata kishin trajtuar përmes filmave të tyre. Tre temat e përzgjedhura për filmat e shkurtër ishin: “Pashaporta”, i cili trajton çështje të migrimit të sigurt, “Problemi yt është problemi ynë” dhe “Nga Mirdita në lagjen Mirdita” të cilët trajtojnë çështje të migrimit të brendshëm dhe problem të hasura nga rinia shqiptare. Filmi i fundit ishte një film humoristik i titulluar “Gëzimi”, i cili përmbante momentet më zbavitëse të shënuara gjatë gjithë javës së kujdesit për stafin. Në të vërtetë, stafi i Mary Ward Loreto ka hapur një dritare të re për prezantimin sa më të mirë të punës së tyre dhe përdorimit sa më efikas të medias dhe multimedias me qëllim trajtimin e çështjeve që shqetësojnë komunitetet tona.

Projekti i MWL për Burrat:

Që nga nisja e projektit, janë dashur rreth 5 muaj punë me vullnetarë dhe punonjës të posaçëm për shpërndarjen dhe mbledhjen e mbi 1000 pyetësorve në periferitë e 10 qyteteve të Shqipërisë, konkretisht në Sarandë, Lushnje, Fier, Berat, Durrës, Tiranë, Lezhë, Shkodër, Pukë dhe Tropojë. Tashmë, MWL për Burrat është një realitet i njohur për shumë prej zonave rurale të Shqipërisë, të cilat kanë patur mundësinë të shprehin përmes fokus grupeve shqetësimet dhe nevojat e komuniteteve të tyre, sfidat që ata hasin për arritjen e synimit për tu bërë proaktiv në përballimin e problematikave të shoqërisë

shqiptare që kanë të bëjnë me fuqizimin ekonomik dhe barazisë gjinore. Përmes intervistave gjysmë të strukturuar, MWL për Burrat ka arritur të krijojë një perceptim më të thellë të mentalitetit që shfaqin burrat në komunitetet e sipër përmendura, si dhe të zbulojë të dhëna interesante të cilat do të publikohen në përfundim të studimit në Shtator. Mr. Steve Coryell, specialisti hulumtues ka shumicën e të dhënave të cilat janë mbledhur gjatë kësaj periudhe 5 mujore. Nga të dhënat do të dalin gjetje interesante të cilat do të na ndihmojnë që të krijojmë një vizion të qartë për të ardhmen e projektit.



Një zhvillim interesant në këtë projekt këtë muaj është fakti që MWL për Burrat ka punësuar 3 punonjës të posaçëm në tre rajone të ndryshme, me qëllim për të ndihmuar menaxherin e projektit. MWL është shumë mirënjohëse ndaj punës së tyre të shkëlqyer.

Azhurnim rreth MWL për të Rinjtë – Trajnim në Durrës rreth “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”

Më 28 dhe 29 Maj, Mary Ward Loreto organizoi në Durrës trajnimin “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”. Ky event është pjesë e komponentit të projektit për të rinjtë për zhvillim njerëzor. Tema përfshiu një modul të plotë mbi mënyrën se si stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimi afektojnë individin dhe shoqërinë. Problematika u trajtua në një mënyrë shumë ndërvepruese, brenda kontekstit social dhe psikologjik. Përmes këtij trajnimi, ne synuam që të nxisim të rinjtë që të rimendonin qëndrimet e tyre dhe të inkurajonin ato pozitive, t’i fuqizonim ata në mënyrë që të praninin imazhin e vërtetë të vetes dhe të influencenin qenien e tyre shoqërore. Të rinjtë ishin shumë dinamikë dhe të interesuar. Aktiviteti i ndihmoi ata që të kenë një përvojë e cila i lidh me ngushtë me njëri tjetrin. Ishte frymëzuese të shihje se si trajnimi i solli ata më pranë njëri tjetrit, pavarësisht faktit që ata po takoheshin për herë të parë dhe se kontekstet nga ata vinin ishin kaq të ndryshme. Ky trajnim iu ofrua të rinjve nga 3 fokus grupe. 27 të rinj nga Lushnja, Tirana dhe Puka morën pjesë në këtë trajnim.



Projekti i MWL për të Rinjtë



Projekti i MWL për të Rinjtë ka vazhduar të organizojë trajnime për grupe të rinjsh në më shumë se 15 zona të Shqipërisë, duke arritur përafërsisht një numër prej 450-500 të rinjsh. Me qëllimin final të parandalimit të trafikimit të njerëzve, këto grupe të synuara kanë qenë pjesë e seancave informuese mbi temën “Kundër Trafikimit të Njerëzve”, si dhe trajnime mbi “Vetë-ndërgjegjësimin” dhe “Zgjidhjen e konflikteve”. Shumica e këtyre trajnimeve janë zhvilluar në ambiente pranë shkollave dhe institucioneve të edukimit. Të tjerat janë mbajtur në ambiente të komunitetit të kishës dhe mjedise të ndryshme sociale. Krahas të rinjve, stafi ynë merr shpesh ftesa edhe nga një audiencë e përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme qeveritare ose jo-qeveritare. Kështu, në muajin Prill, projekti MWL për të Rinjtë organizoi një trajnim në formën e një debati të hapur në Rrëshen, në mjedise të ofruara nga Administratori Rajonal. Grupi zhvilloi një bisedë konstruktive mes përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe atyre nga institucionet qeveritare. Shumë pyetje dhe ide lindën dhe u diskutuan aty. Mund të konsiderohet padyshim një qasje e sukseshme për MWL që të analizojë këto tematika me sektorë të ndryshëm të shoqërisë.

Puna Kundër Trafikimit në Angli

Nga data 8 deri më 18 Prill 2016, dy pjesëtarë të stafit të projekteve të grave dhe të rinjve, Afërdita Gjoni dhe Sara Çapaliku ishin për vizitë në Mretërinë e Bashkuar. Vizita konsistoi në një prezantim të mbajtur në Jork më datë 11 Prill 2016, në “Bar Convent” me miq të Mary Ward. Tema e takimit ishte “Një Grua e Mary Ward në Misionin e Luftimit të Trafikimit të Njerëzve”. Njëzetë e dy pjesëmarrës e ndoqën takimin. Kishte një interes shumë të lartë mbi punën që po bën Fondacioni Mary Ward Loreto në Shqipëri përmes projekteve të tij dhe në bashkëpunim me partnerët. Falë këtij takimi kaq të suksesshëm, disa hapa konkretë u ndërmorën nga pjesëmarrësit të cilët treguan gatishmërinë e tyre për të ngritur një grup mbështetës për trajtimin e projekteve dhe nismave që stafi i Mary Ward Loreto mund të konsiderojë se kanë nevojë për mbështetje financiare apo çfarëdolloj mbështetje tjetër.



Vizita në Jork u ndoq nga Takimi Vjetor i ANDANTE “Aleanca Evropiane e Organizatave të Grave Katolike”, në High Leigh. Kjo ishte një konferencë katër ditore e cila përfshiu plane strategjike. ANDANTE ka status pjesëmarrës si OJQ ndërkombëtare në Këshillin e Evropës dhe është anëtare e Konferencës Ndërkombëtare të Organizatave Jo-Qeveritare të përfaqësuara në Këshillin e Evropës. Krahas punës për ditën studimore, ANDANTE festoi 10 vjetorin e themelimit të saj dhe prezantoi sukseset që ata kanë qenë në gjendje të arrijnë në këto dhjetë vite. ANDANTE po lobon për çështje si trafikimi i njerëzve dhe varfëria, por ka gjithashtu si prioritet forcimin e zërit të grave brenda Kishës Katolike.

Dy anëtarët e stafit të projekteve të Mary Ward Loreto lobuan fort rreth çështjeve që lidhen me trafikimin e njerëzve si forma të skllavërisë së ditëve moderne. Ndër prioritetet e përzgjedhura për tu trajtuar nga ANDANTE gjatë vitit të ardhshëm, do të jenë: 1. Trafikimi/skllavëria e ditëve moderne; 2. Gratë në Kishë; 3. Refugjatët/Migrantët.

Seminar për Zhvillimin dhe Drejtimin e skuadrave të Vullnetarëve

Seminari u mbajt në Zagreb, Kroaci, nga data 18 deri 20 Maj 2016. Trajnimi u organizua nga Fondacioni ERSTE në kuadër të programit NGO Academy. Programi synon të forcojë Shoqërinë Civile në Evropën Qendrore dhe Jug-Lindore përmes ofrimit të mundësive të mëtejshme të edukimit. Konkretisht, trajnimi ishte një mundësi për të njohur më mirë nevojën për vullnetarë karshi asaj çfarë vullnetarët kanë nevojë. Seanca e parë ishte e përqendruar më së shumti në një shqyrtim teorik të mënyrës se si mund të formojmë me sukses bashkëpunime vullnetare, dhe më pas, seanca e dytë zgjeroi konceptet teorike me përvoja praktike nga pjesëmarrësit dhe organizatat e tyre. Atje ishin të pranishëm 14 persona nga 9 shtete të ndryshme Evropiane. Seminari ishte mjaft i dobishëm për ndërtimin e aftësive të menaxhimit ndërpersonal. Ishte gjithashtu një mundësi e shkëlqyer për të takuar njerëz të rinj të cilët punojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe ndajnë të njëjtat vlera dhe punë.



Familja në një kontekst botëror: këndvështrime aktuale dhe të së ardhmes



Më datë 25 Maj 2016, në ambientet e Universitetit Katolik të Zojës së Këshillit të Mirë u mbajt konferenca "Familja në një kontekst botëror: këndvështrime aktuale dhe të së ardhmes". Eventi ishte organizuar si bashkëpunim i Universiteteve Zoja e Këshillit të Mirë dhe Hëna e Plotë. Pjesëmarrës nga politika dhe komunitetet fetare ishin të pranishëm për të dhënë mesazhet e tyre, duke përfshirë Presidentin e Republikës, Z. Bujar Nishani, Nuncin apostolik në Shqipëri, Kryepeshkvin Ramiro Moliner Inglés, ambasadorin e Italisë në Shqipëri, Alberto Cutillo, Monsinjon Vincenzo Paglia, Rektorin e Universitetit Katolik, Prof. Bruno Giardina dhe Rektorin e Universitetit Bedër, Prof. Ferdinand Gjana. Këta të fundit, e vlerësuan jashtëzakonisht bashkëpunimin mes dy institucioneve. Përfaqësues nga Fondacioni MWL morën pjesë gjithashtu në këtë veprimtari.

Konferenca theksoi funksionin shoqëror të familjes: nëse familja shkon në krizë, atëherë kriza shtrihet në të gjithë shoqërinë. U theksua gjithashtu përgjegjësia për të edukuar gjeneratën e re rreth familjes. Kjo konferencë mbështeti nismën e institucioneve të cilat kërkojnë mbrojtjen e vlerave të familjes së natyrshme dhe mbrojtjen nga rreziqet që dhunojnë parimet themelore të familjes.

Vullnetarët

Gjatë 5 muajve të fundit, dy vullnetarë janë bërë pjesë e ekipit të MWL për Burrat në shumë veprimtari që lidhen me projektin. Kontributi i tyre ka qenë i paçmuar. Pavarësisht mungesës së përvojës, djemtë kanë treguar një përkushtim dhe angazhim të admirueshëm, përmes zbatimit në linjë me planin e veprimit të njohurive të tyre teorike të përfuara në universitetin ku ata studiojnë (Fakulteti i Shkencave Sociale). Angazhimi i tyre ka përfshirë shpërndarjen e pyetësorve dhe intervistat kokë më kokë me burra në komunitete të ndryshme ku është shtrirë projekti.

Me këtë rast falenderojmë profesorët e tyre mbikqyrës të cilët kanë treguar gatishmëri për të bashkëpunuar me projektin MWL për Burrat në këtë drejtim. MWL për Burrat inkurajon gjithashtu të rinj të tjerë të cilët janë të gatshëm të kontribuojnë në faza të tjera të projektit, duke qenë se kontributi i vullnetarëve është i një rëndësie parësore.



Forcimi i Aftësive të Lidërshipt tek Policet Femra: Trajnimi kundër Trafikimit

MWL dhe partnerët Të Ndryshëm dhe të Barabartë, Engjëjt e Vegjël, dhe partneri ynë nga Projekti Roma ishin të ftuar për të ndarë përvojën e tyre me një grup police femra në Tiranë, të cilat po trajnoheshin për pozicione drejtuese. Konkretisht, ne ishim ftuar që të flisnim rreth punës kundër trafikimit i cili është fokusi ynë. Gjithashtu, pjesëmarrësit folën edhe rreth punës së bërë gjatë gjashtë projekteve të rrjetit me Policinë Shqiptare. Ky takim ishte një mundësi për të forcuar më tej partneritetin me Policinë Shqiptare për të luftuar trafikimin e njerëzve. Të pranishme në takim ishin katërmbehdhjetë police femra të cilat u përfshinë në mënyrë mjaft aktive në diskutim teksa punonjësit e ekipit tonë ndanin historitë dhe përvojat e tyre. Policet femra të pranishme në këtë takim shfaqën një interes të lartë për të ditur më shumë rreth punës tonë, si dhe shprehën gatishmëri për të bashkëpunuar dhe të na mbështesnin në rastet që na paraqiteshin. Ato ndanë gjithashtu historitë e tyre dhe pohuan se kishin nevojë për më shumë bashkëpunim me OJQ-të të cilat mund të ndihmonin policinë në trajtimin e rasteve të tyre. Në vijim të kësaj vizite dhe reflektimeve të bëra nga policet femra përpara shumë personave të tjerë, ne kemi patur dy kërkesa të tjera për takime me persona të tjerë, nga ambasada e Sh.B.A dhe OSBE.



Logjistika në Mary Ward Loreto

Mary Ward Loreto punësoi një punonjës të ri në Prill. Emri i tij është Albert Lala dhe ai punon si ndihmës i ekipit të Logjistikës dhe shofer. Për Mary Ward Loreto është shumë e rëndësishme që, teksa zgjerohet, të ketë një staf shumë të mirë në dispozicion të ekipit të logjistikës në mënyrë që të sigurohet udhëtim i sigurt i stafit në zona të ndryshme të vendit, si dhe çdo event të menaxhohet më së miri. Berti është një anëtar i ri shumë i mirëpritur në stafin e MWL. Gjatë kësaj periudhe po organizohet fushata e UNGift box. Kjo po kërkon shumë kohë dhe energji nga ekipi i logjistikës. Kjo fushatë e UNGift Box kundër trafikimit të qenieve njerëzore është organizuar tashmë në 6 shtete të tjera. Stafi i logjistikës do të merret me organizimin dhe ndërtimin e kutisë. Për të parë foto të këtij eventi kontrolloni faqen tonë në Facebook rreth datës 26 korrik.

Takimi i bordit të MWL

Më 9 Maj, në zyrat e MWL u mbajt takimi i Bordit të Drejtuesve. Qëllimi i këtij takimi ishte azhurnimi dhe ndarja e informacionit mbi projektet dhe zhvillimet më të fundit, si dhe për të kërkuar këshillën e tyre mbi çështje që kanë të bëjnë me organizatën. Jemi shumë falendërues ndaj përkushtimit të tyre dhe gatishmërisë për të na ndihmuar me njohuri, ekspertizë, kontakte publike dhe promovim.

Kryetari i Komisionit Katolik të Arsimit

Gjatë kësaj periudhe, kryetarja e Komisionit Katolik të Arsimit për Kishën Katolike, Motër Teuta (Salesian), kontaktoi MWL për të kërkuar mbështetje për zhvillimet e tyre të ardhshme dhe analizën e shkollave të tyre. Kemi rënë dakord që të mbështesim këtë punë dhe dëshirojmë që të ndajmë me to disa prej materialeve tona hulumtuese sapo kërkimi ynë shkencor në nivel kombëtar të ketë përfunduar, me qëllim që t'i ndihmojmë ato në analizën që po bëjnë. Presidentja e MWL është ftuar që t'i bashkëngjitet një skuadre këshillimore, e cila po ngrihet nga Komisioni Katolik për Arsimin me qëllim për të mbështetur këtë ripërtëritje në shkollat e tyre.



Programi i menaxhimit dhe inovacionit shoqëror

Nga Marsi deri në Qershor 2016, menaxherja e projektit të MWL për Gratë ndoqi programin NGO Academy të Fondacionit ERSTE. Ky program zbatohet në bashkëpunim me Qendrën Kompetente për Organizatat Jo-Fitimprurëse dhe Sipërmarrje Sociale të Universitetit të Ekonomisë dhe Biznesit të Vjenës (WU Vienna). Ata u përqendruan në zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave menaxhuese dhe trajtuan një larmishmëri tematikash relevante, me qëllim konsolidimin e organizatave jo-fitimprurëse dhe stafit të tyre drejtues. Programi kombinoi një orientim praktik me një bazë solide të njohurive të ekspertëve duke i ofruar kështu menaxheres së MWL për Gratë mundësinë e zgjerimit të njohurive dhe aftësive të saj për menaxhimin e projektit të MWL për Gratë, si dhe për të përdorur informacion të ofruar nga ekspertët gjatë përballimit të sfidave specifike të hasura në punë dhe trajtimin të tyre në mënyrë profesionale. Jemi mirënjohës ndaj stafit të programit NGO Academy të Fondacionit ERSTE për ofrimin e këtyre njohurive dhe përmirësimin e aftësive.



Projekti në Burgje

Çdo të Hënë, të dënuarit në burgun e Fushë Krujës janë të lumtur për faktin se në orën 11:00 ata vizitohen nga një përfaqësues i projektit të MWL për Burrat. Kushtet në burgjet shqiptare janë të mjerueshme, ku mungojnë elementët bazikë si uji i pijshëm apo një mjedis normal fjetje. Shërbimet sociale apo veprimtaritë çlodhëse janë shumë të pakta. Prania e fondacionit tonë bën që të burgosurit të dinë se nuk janë lënë në harresë. Vizita u jep burrave në burg një motiv për të mbijetuar dhe që të harrojnë stresin e përditshëm dhe traumën. Një grup prej rreth 20 të burgosurish janë pjesë e takimeve të përjavshme, në të cilat diskutohen probleme të ndryshme në ambientet e burgut. Ata trajtojnë gjithashtu çështje që kanë të bëjnë me shoqërinë në përgjithësi, përmes të cilave ata ndajnë përvojat e tyre gjatë diskutimit. MWL për Burrat ka mundësinë që të ndër marrë nisma të ndryshme të cilat bëjnë të mundur që personat që vuajnë një dënim me burgim të jenë më të angazhuar në një ambient vërtet ndrydhës. Shpesh, shfaqen filma me tema të cilat mundësojnë burrat që të shprehin ndjesitë e tyre, idetë dhe përshtypjet për jetën, ashtu siç e shohin ata. MWL për Burrat synon që të vijojë me këto veprimtari dhe t'i zgjerojë ato më tej. Pasi shkon për të ndihmuar në këto burgje, ndjen më tepër sesa kurrë nevojën që punonjësit e MWL për Burrat të jenë atje në një kohë kaq të vështirë për jetët e atyre burrave.



Mbështetja financiare

Fatkeqësisht, gjatë kësaj periudhe raportimi zbuluam se burimi ynë i mbështetjes financiare për studentët në universitet, në nivel master, është mbyllur dhe se Fondacioni me të cilin jemi lidhur ka mbyllur departamentin e tij për ndihmën financiare. MWL është në kontakt me një student, familja të cilit është futur tashmë në borxhe për ta ndihmuar atë, i cili e ka të pamundur të vijojë studimet universitare në vitin e dytë të Masterit në Ekonomi. MWL ka vendosur që të mbështesë financiarisht për një vit shpenzimet universitare të këtij studenti të ri, përmes sigurimit të fondeve të ndryshme për këtë qëllim. Ndërkohë, ai do të sigurojë një vend pune që të mbulojë strehimin dhe shpenzimet e tjera. Jemi të lumtur që mbajmë lart përkushtimin tonë për mbështetjen e kësaj familje në vështirësi. Ne po mbledhim ndërkohë fonde për këtë qëllim, kështu që nëse ju mund të ndihmoni, lutemi të kontribuoni përmes faqes tonë në internet për Rritje Fondesh: www.albaniahope.com.

Stazhierët e MWL

Ky është viti i parë që MWL pret stazhierë dhe deri më tani ka rezultuar një eksperiencë impresionuese. Dy studentë nga Fakulteti i Shkencave Sociale ndoqën prezantimin e punës së MWL në zhvillimin e punës në komunitet për transformim social, parandalim të trafikimit të njerëzve dhe instrumentat dhe metodikat e punës. Prezantimi me Fondacionin Mary Ward Loreto u krye nga Presidenti, Imelda Poole, IBVM. Ata kanë ndjekur trajnimin në Durrës të MWL për Gratë Drejtuese mbi tematikën e Organizimit me Bazë të Gjerë, dhe janë aktualisht në fazën e njohjes së punës në nivel komuniteti me gratë e qendrave të MWL në Lezhë, Hot i Ri dhe Shkodër. Projektet e MWL për Burrat dhe Të Rinjtë kanë trajnuar gjithashtu stazhierë për të punuar në terren me veprimtari të ndryshme që po ndodhin.



Trajnimi i Drejtueseve rreth Organizimit me Bazë të Gjerë

Projekti i Mary Ward Loreto për Gratë synon që të fuqizojë gratë në mënyrë që të ndërmarrin aksione në komunitet dhe të bëhen aktorë aktiv në komunitetet e tyre, me qëllim që të ofrojnë shpresë, ndihmë dhe ndryshim. Drejtueset nga grupet e grave në 5 zona të Shqipërisë ndoqën një trajnim rreth Organizimit me Bazë të Gjerë, të zhvilluar në Durrës. Në fund të trajnimit, drejtueset nga secila zonë identifikuan çështje specifike të cilat kanë nevojë të trajtohen në mënyrë që të nxisin vetë-mjaftueshmëri, të forcojnë komunitetet dhe të advokojnë për politika publike. Hapi tjetër mbetet organizimi i grupeve të grave dhe komunitetit për të vlerësuar nevojat dhe problematikat, si dhe të gjenden zgjidhje.



Rrjetëzimi në Lezhë

Rrjetëzimi në Mary Ward Loreto pasqyrohet në çdo nivel, duke filluar nga niveli menaxherial për të vazhduar në zonat e zhvillimit të projektit në komunitetet ku projekti i MWL për Gratë po vepron. Në punën tonë të përditshme, rrjetëzimi konsiderohet tejet thelbësor duke qenë se kontribuon në bërjen të qëndrueshme të punës sonë në lidhje me partnerët. Rrjetëzimi fuqizon gjithashtu gratë me të cilat ne punojmë në komunitetet e largëta.

Rrjetëzimi me partnerët dhe institucionet e qeverisjes lokale na ndihmon që të përballemi me probleme të cilat kërkojnë veprim të përbashkët. Eksperienca ka treguar se pa bashkëpunim me institucionet, OJQ-të e tjera dhe anëtarët e komuniteteve është e vështirë të realizojmë qëllimin tonë për ndryshim shoqëror.

Prandaj, ne punojmë dhe bashkëpunojmë ngushtë me partnerët lokalë, duke ndarë me ta përvojat e trajnimeve si dhe duke kërkuar për interesa të përbashkëta me qëllim nxitjen e fuqizimit të personave vulnerabël me të cilët punojmë. Ne përdorim rrjetëzimin si mjet për trajtimin e nevojave të grave dhe vajzave, si dhe në përpjekje për të përmirësuar shërbimet shtetërore për personat më vulnerabël dhe për të fuqizuar komunitetet tona.



Hapja e Tregut të punimeve artizanale në Valbonë

Një aspekt i zhvillimit të biznesit të grupit shoqëror të grave të projektit MWL për Gratë në Tropojë ishte hapja në Valbonë e një kioske të drurit për shitjen e punimeve artizanale. Turizmi i Valbonës po frekuentohet gjithmonë e më shumë nga turistë nga e gjithë bota, kështu që njihet paraprakisht potenciali i kësaj nisme. Për disa muaj rresht, MWL për Gratë kanë punuar për të identifikuar dhe siguruar një marrëveshje të përshtatshme me pronarin e tokës si dhe për të studiuar modelin e drurit që do të përdorej. Kjo kioskë është ndërtuar dhe vendosur tashmë në Valbonë. Aktualisht, po tregohet interes dhe produktet po shiten. Stafi i MWL ka punuar në grupe për të organizuar ditën e hapjes së eventit në një vend të quajtur "Krojet e Rrogamit." Në këtë kiosk punimesh artizanale, një grua sipërmarrëse po tregton një varietet punimesh artizanale të realizuara nga gratë e Kallmetit, si bizhuteri, kartolina, çanta dhe portofola për femra, si dhe rroba të punuara me dorë, si p.sh. rroba për fëmijë, bluza, veshje tradicionale të zonës apo edhe aksesore për qepje, enë kuzhine, qirinj dhe prodhime bimore, si çaji i malit. Pika e fortë e kësaj nisme është se ne nuk po konkurrojmë me shitës të tjerë vendas, pasi në Valbonë nuk ka një shërbim të tillë. Janë gjithsej 15 gra të cilat punojnë për të sjellë në treg produktet e kërkuara. Cilësia dhe tregtimi i produkteve në Valbonë do ta bëjnë këtë nismë biznesi social mjaft të suksesshme.



Kartolinat e qendisura

Aktiviteti i kartolinave të qendisura ka njohur rritje në drejtim të cilësisë së këtij produkti dhe zgjerimit të tregut në Shkodër dhe jashtë vendit. Qytete si Tirana dhe Durrësi janë gjithashtu në listën e përpjekjeve për zgjerimin e tregut. Grupi i MWL për Gratë erdhi në treg me veçori të reja të cilat rezultuan të suksesshme dhe bënë që blerësit të bënin shumë komplimente për gratë e grupit. Aktualisht janë dy grupe pune, një grup profesionist dhe një tjetër fillestar, të cilët po mësojnë ende. Ato mblidhen së bashku në qendër, ku punojnë dhe mbështesin njëra tjetrën. Një grup grash, së bashku me një punonjës kyç po promovojnë dhe shesin kartolina në Shkodër. Kjo i ka ndihmuar ato që të njohin tegun, llojet e klientëve, teknikat e komunikimit dhe marketimit, si dhe sfidat gjithashtu. Përveç promovimit të kartolinave, klientët janë njohur dhe me punën e MWL dhe përpjekjet e organizatës për fuqizimin e grave. Ky rrugëtim i suksesshëm ka qenë një nxitës mjaft i fortë për gratë, të cilat janë bërë gjithmonë e më aktive në punë, duke konsideruar atë tashmë një punë me kohë të plotë. Mes grupit të grave ekzistojnë dinamika shumë pozitive: ato janë bërë edhe më të shoqërueshme dhe mbështetëse të njëra tjetrës. Ndjesia e përkatësisë është rritur.



Hapja e Tregut të Punimeve Artizanale në Parkun Arkeologjik të Apollonisë

Një Treg i Punimeve Artizanale do të hapet në Parkun Arkeologjik të Apollonisë, në Fier. Ky është një prej synimeve më madhore të grupit të grave në Fier. Ky treg ka për qëllim që të fuqizojë ekonomikisht gratë përmes promovimit të aftësive të tyre artizanale. Gratë e MWL do të shesin produktet e tyre ndaj blerësve të huaj të cilët vizitojnë vendin turistik të Apollonisë. Rrugëtimi i një sipërmarrjeje ekonomike origjinale është i vështirë. Mbështetur në eksperiencën e panaireve të fundit, të gjithë faktorët që bëjnë të suksesshëm një sipërmarrje janë adresuar, duke filluar nga produkti, struktura e procedurave të jashtme ligjore për hapjen e një biznesi të vogël, marketimi, si dhe të kuptuarit dhe përmbushja e nevojave të blerësve. Grupi i grave të MWL në Fier po presin një përgjigje nga Ministria e Kulturës për t'i ndihmuar ato që të kenë një fillim të mbarë. Gratë janë të emocionuara dhe në ankth për të filluar sa më shpejt që të jetë e mundur. Periudha e turistëve zgjat vetëm për pak muaj. Nëse do të ketë sukses, kjo nismë do të përsëritet në çdo sezon.



Si mesazh të fundit, Mary Ward Loreto edhe njëherë ju uron pushime të mbara këtë verë dhe një udhëtim të sigurtë kudo që të shkoni. Nëse do ndodheni në Shqipëri, ju lutemi ejani dhe bashkohuni me ne, në fushatën tonë UN Gift Box. Na ndiqni në faqen tonë në facebook MaryWardLoreto dhe faqen e internetit www.albaniahope.com.